



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 737/23
Nr. i fq. / Br. st _____
Data: / Datum 14.06.2023
VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenin 44 pika 3 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera nr. 04/L-027, nenin 44 paragr. 1 të Statutit të komunës, pas gjendjes së krijuar në terren me rastin e vërvshimeve nga reshjet e shiut në orët e vona të pasdites së datës 14.06.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIM TË SHTABIT PËR GATISHMËRI EMERGJENTE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

1. Me qëllim të ndërmarrjes së masave për tejkalim të gjendjes së krijuar në terren nga reshjet e shiut, formohet Shtabi për Gatishmëri Emergjente në këtë përbërje:
 1. **Ferit Idrizi**, Kryetar i Komunës, kryesues i shtabit
 2. **Shpëtim Zhegrova**, zv.kryesues
 3. **Maliq Ferizi**, Drejtor i DMSH-së, anëtar,
 4. **Bajram Beqiri**, zyrtar në DMSH, anëtar,
 5. **Benjamin Shala**, Drejtor i DSHP, anëtar
 6. **Nexhmedin Rashica**, Drejtor i DSHS, anëtar,
 7. **Ergin Sunguri**, Drejtor i EBPZHR, anëtar
 8. **Dardan Abazi**, Drejtor i Arsimit, anëtar
 9. **Reshat Kovaçi**, Komandant i Stacionit Policor, anëtar
 10. **Fadil Hyseni**, Shef i Nësisë së Zjarrfikësve
 11. **Fadil Bahtiri**, Kryeshek I NPL "Përpatrimi", anëtar
 12. **Përfaqësuesi i Kryqit të Kuq** në Vushtrri, anëtar
 13. **Mirjeta Duraku**, Zyrtare për informim, anëtare
 14. **Përfaqësuesi i KEDS- it**, anëtar
 15. **Shefqet Maloku** Menaxheri i KRU Njësia në Vushtrri
 16. **Përfaqësuesi i Shoqatës së Peshkatarëve** në Vushtrri, anëtar
1. Bazuar në Planin Komunal për Mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqpësitë tjera Shtabi emergjent duhet të përcjellë 24 orë situatën në terren, dhe koordinoj punët dhe veprimet e tij, të bashkëpunoj me Policinë e Kosovës, KEDS-in, Ujësjellësin Rajonal "Mitrovica", Njësia në Vushtrri dhe akter tjerë relevant të ndërlidhur në këto situate emergjente, me qëllim të mbrojtjes së popullatës dhe të mirave materiale nga vërvshimet.

2. Drejtorët përkatës të drejtorive komunale duhet të ofrojnë mbështetjen e duhur për Qendrën apo ekipet në terren gjatë gjithë kohës sa zgjat gjendja e emergjente si dhe të i kenë në dispozicion në çdo moment të hapur telefonat mobil.
3. Shtabi Emergjent do të përcjell situatën në terren dhe sipas nevojës informoj me kohë qytetarët lidhur me gjendjen në terren për të përballuar sa më lehtë dhe pa pasoja situatat emergjente.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.



Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të shtabit emergjent
- Arkivit të sekretarisë